



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2022:027681

Datë: 30.05.2022

Numri i dokumentit: 03074854

CT.nr.02/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni civil, me gjyqtarin Naim Rekalju, me zyrtaren ligjore Kaltrina Sfarqa, në çështjen juridike trashëgimore të trashëgimlënësit I.(Sh.) O. ish nga fshati M., komuna V. duke vendosur sipas propozimit për shqyrtimin e trashëgimisë të propozuesve Sh.O. nga fshati M., komuna V., jashtë seance, me datën 30.05.2022, e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Në tërë masën trashëgimore të lënë pas vdekjes së të ndjerit I. (S.) O. ish nga fshati M. komuna . i vdekur me datën 21.07.2021 me numër personal .... RKS, e cila përbëhet nga pasuria e luajtshme në të holla, në shumë prej 2634.78 euro, të njohura sipas aktgjykimit të plotfuqishëm C.nr.3443/12 i datës 26.12.2018, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në emër të trashëgimlënësit I. O., ish nga fshati M. komuna V..

**SHPALLET TRASHËGIMTARE LIGJORE**

1.Xh. O., e veja e të ndjerit, e lindur me datën ..., në fshati .S. komuna V., nga i ati A., e ëma Z., me numër personal ..., shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, tani me vendbanim në fshatin M., komuna V., në pjesë prej 1/1 të pasurisë së lartcekur të trashëgimlënësit I. O..

## A r s y e t i m

Në këtë gjykatë me datën 11.02.2022, propozuesit Sh.O. nga fshati M., komuna V., ka iniciuar procedurën trashëgimore për shqyrtimin e masës trashëgimore pas vdekjes së trashëgimlënësit I. O. ish nga V. për pasurinë e cila është përshkruar në dispozitiv, gjegjësisht pasuria e luajtshme në shumë prej 2634.78 euro, e cila shumë është njohur për trashëgimlënësin sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile C.nr.3443/2012 i datës 26.12.2018 dhe i plotfuqishëm sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1666/2019, datë 23.07.2021.

Gjykatës me datën 22.04.2022, pa ftesë i kanë prezantuar trashëgimtarët e trashëgimlënësit, i biri, Sh. O. dhe e veja, Xh. O..

Në seancën e datë 22.04.2022, trashëgimtari-i biri i trashëgimlënësit, Sh. O. pasi që u njoftuar me të drejtat e tij trashëgimore dhe se deklarata trashëgimore është e parevokueshme, deklaroi se merr pjesë në masën trashëgimore të trashëgimlënësit, që i takon sipas ligjit, por njëherit heqin dorë në favor të nënës Xh. O.

Në seancën trashëgimore të datës 22.04.2022, trashëgimtari - e veja Xh. O., pasi që u njoftua me të drejtat e tij trashëgimore dhe se deklarata trashëgimore është e pa revokueshme, deklaroi se merre pjesë në masën trashëgimore të të ndjerit, ndërsa nuk ua mohon të drejtën në trashëgimi, trashëgimtarëve të tjerë ligjor.

Gjykata në pajtim me nenin 32 të Ligjit nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për Procedurën Jo kontestimore, ka shpallë njoftimin në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka prit konform kësaj dispozite ligjore, një muaj kohë, nëse eventualisht do të paraqiten në këtë gjykatë, ndonjë trashëgimtarë tjetër eventual dhe meqenëse brenda afatit njëmuajor nuk është paraqit asnjë trashëgimtar tjetër eventual, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të dëshmisë së vdekjes së datës 10.02.2022, vërtetohet se i ndjeri I. O. ka vdekur me datë 21.07.2021 dhe si trashëgimtar ligjor të rendit të parë ka lënë të të birin Sh. O. dhe bashkëshorten Xh. O., nga pasuria e paluajtshme nuk ka lënë asgjë, ndërsa sipas aktgjykimit të

Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile C.nr.3443/2012 i datës 26.12.2018 dhe i plotfuqishëm sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1666/2019, datë 23.07.2021, vërtetohet se ka lënë pasurinë e luajtshme në shumë prej 2634.78 euro, e cila evidentohet si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në emër të trashëgimlënësit, në pjesën ideale 1/1, ndërsa nuk ka lënë testament.

Nga certifikata e vdekjes e datës 26.07.2021, vërtetohet se i ndjeri ka vdekur me datën 21.07.2021, në Sh., Republika e Sh., ndërsa me vendbanim të fundit në fshatin M. komuna V.

Nga certifikatat e lindjes, në emër të trashëgimtarit Sh.O., vërtetohet se i njëjti është i biri i trashëgimlënësit I. O. ndërsa nga certifikata nga arkivi e datës 08.02.2022, vërtetohet se trashëgimtarja Xh. O., është e veja e tij dhe se martesën e kanë lidhur me datë 09.11.1987 në D. me I.O. dhe ka marrë mbiemrin e trashëgimlënësit O. regjistri martesor nr. 24.1987, por me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë C.nr.76/2003 të datës 16.09.2003, martesë është zgjidhur, ndërsa kanë lidhur martesën përsëri me datë 26.11.2018, e cila martesë ka zgjatur deri në vdekjes e trashëgimlënësit me datë 21.07.2021.

Andaj, gjykata e shpalli si trashëgimtare ligjore bashkëshorten e trashëgimlënësit, Xh. O. pasi që më parë ka vërtetuar se bashkëshortja e trashëgimlënësit i plotëson të gjitha kushtet ligjore për të qenë trashëgimtare e të ndjerit, ndërsa për të trashëguar pasurinë në pjesën prej 1/1, të tërë pasurisë trashëgimore, gjykata e vendosi konform nenin 130 par. 1 të LTK-së, pasi që trashëgimtari-i biri i trashëgimlënësit, Sh. O. në seanca mbi trashëgimin ka heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 11, 12, 130 par 1 të Ligjit për Trashëgimin të Kosovës dhe nenit 171 të Ligjit për Procedurën Jo Kontestimore.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CT.nr.02/2022 e datës 30.05.2022

Gj y q t a r i  
Naim Rekalii

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimin. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.